



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:164131

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733376

P.nr.../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit D..... M....., për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1268/23 të datës 31.07.2023, jashtë seancës gjyqësore me datë bie këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr.../... e datës, lidhur në mes të pandehurit D..... M.... dhe te dëmtuarit A..... S.....nga Peja Rr.”R.... L...”nr. .

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore ne Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1268/23 të datës 31.07.2023.

III. PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit D..... M....., i lindur me datë, nga i babai E... e nënës H.... e gjinisë N..., në P... ku edhe banon në Rr R... L... nr..., ka të kryer shkollën fillore me profesion Auto limarë, i gjende mesme ekonomike, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. prs....., Egjiptian, shtetas i Republikës së Kosovës.

- për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 31.07.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.1268/23 të datës 31.07.2023 ndaj të pandehurit D..... M....., për shkak të veprës penale sulm nga neni 184 të KPRK-së .

Me datën është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit D..... M.... dhe te dëmtuarit A..... S....., e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr..../. e datës, lidhur në mes të pandehurit D.... M.... dhe te dëmtuarit A.... S.....

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërpre në procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,
DIVIZIONI PENAL
2023:164131, 24.05.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

Gjyqtari

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashetrojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi